

UDHËZIM
Nr. 2, datë 9.1.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËRKATËS PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË
FATIT PËR SHITJEN, LËNIEN PENG, DHURIMIN DHE ÇDO FORMË TJETËR TË
DISPONIMIT TË AKSIONEVE, ASETEVE, PASURISË APO MAKINAVE TË
ORGANIZATORIT TË LEJUAR PËR ZHVILLIMIN E LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 18, pika 11 dhe të nenit 70, pika 6, të ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit përkatës për miratimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (këtu e mëposhtë referuar si “AMLF”) të shitjes, lënies peng, dhurimit dhe çdo forme tjetër të disponimit të aksioneve, asetëve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit.

2. Shoqëritë e licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit, përpara se të shesin, të lënë peng, të dhurojnë, si dhe të disponojnë në çdo formë tjetër aksionet, asetet, pasuritë apo makinat duhet të marrin miratimin e AMLF-së.

3. Identifikimi i aksioneve, asetëve, pasurive apo makinave të shoqërive të licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit bëhet në përputhje me dokumentacionin që lëshohet nga organet kompetente për regjistrimin e aksioneve, pasurive dhe asetëve sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

4. AMLF-ja me marrjen e kërkesës për dhënie e miratimit për shitjen, lënien peng, dhurimin dhe çdo formë tjetër të disponimit të aksioneve, asetëve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit, në çdo rast informon me shkrim ministrin e Financave.

KREU II
DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR DHËNIEN E MIRATIMIT

5. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit me qëllim marrjen e miratimit nga AMLF-ja përpara shitjes, lënies peng, dhurimit, si dhe çdo formë tjetër të disponimit të aksioneve, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) njoftimin nga shoqëria e licencuar në fushën e lojërave të fatit për shitjen, transferimin, lënien peng, dhurimin apo çdo formë tjetër të disponimit të aksioneve të shoqërisë,

b) vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë që miratojnë shitjen, lënien peng, dhurimin apo çdo formë tjetër të disponimit, të aksioneve të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe dispozitave të statutit të shoqërisë;

c) vërtetimin nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj shtetit;

d) dokument që vërteton që shoqëria nuk është në proces likuidimi dhe/ose falimentimi.

6. Subjektet juridike, të cilëve i transferohen aksionet e shoqërive të licencuara në fushën e lojërave të fatit, nëpërmjet blerjes, dhurimit, lënies peng ose çdo forme tjetër disponimi duhet të paraqesin pranë AMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit të shoqërisë;

b) statutin e shoqërisë dhe/ose aktin e themelimit;

c) ekstrakt historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit ku të vërtetohet se shoqëria është në status aktiv dhe nuk është në procedurë likuidimi dhe/ose falimentimi, si dhe nuk është i çregjistruar;

d) deklaratat e burimit të kapitalit dhe shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit në rastet e transferimit të aksioneve nëpërmjet shitblerjes;

e) dokumentacion të plotë në lidhje me aksionarët e shoqërisë përfituese të aksioneve, nga i cili të dalë qartë struktura e pronësisë së shoqërisë, informacioni për kapitalet dhe interesat e aksionarëve/ortakëve në shoqëri të tjera, si dhe të identifikohet deri në fund individ/individët përfitues;

f) vërtetim nga organet tatimore që shoqëria nuk ka detyrime tatimore të pashlyera;

g) dëshmi penaliteti, vërtetime nga gjykata që nuk janë në proces gjyqësor dhe nga prokuroria që nuk janë në procedim penal, si dhe vetëdeklarimin që vërteton gjendjen penale për administratori/ët dhe ortakët/aksionarët e shoqërisë përfituese të aksioneve.

h) dokumente që të vërtetojnë se aksionarët /ortakët dhe administratori/ët e shoqërisë përfituese të aksioneve nuk janë të dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që kompromentojnë personin në nderin e personalitetin e tij.

7. Nëse subjekti, të cilit i transferohen aksionet nëpërmjet blerjes, dhurimit, pengut ose çdo forme tjetër të disponimit të aksioneve është individ, duhet të paraqesë paraprakisht pranë AMLF-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vërtetimin se subjekti nuk është i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë dhe nuk është në ndjekje penale për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/ose doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që kompromentojnë personin në nderin e personalitetin e tij;

b) vërtetimin se subjekti nuk është në proces gjyqësor për vepra penale të parashikuara në germën “a” të kësaj pike;

c) vërtetim nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor se subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Për vërtetimin e përmbushjes së këtyre kërkesave, individ duhet të depozitojë pranë AMLF-së, dëshmi penaliteti, vërtetime nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor, nga prokuroria që nuk është në procedim penal dhe nga shërbimi përmbarrimor që nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm.

8. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit, me qëllim marrjen e miratimit paraprak nga AMLF-ja përpara shitjes, lënies peng, dhurimit, si dhe çdo formë tjetër të disponimit të pasurisë, aseteve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit të shoqërisë në rastin kur përfituesi është i organizuar si person juridik;

b) statutin e shoqërisë dhe/ose aktin e themelimit;

c) ekstrakt historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit ku të vërtetohet se shoqëria është në status aktiv dhe nuk është në procedurë likuidimi/çregjistruar;

d) vërtetim nga organet tatimore që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera;

e) vërtetimin e pronësisë së pasurisë/aseteve në rastin kur lëshimi i certifikatës së pronësisë është i parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

9. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit me qëllim marrjen e miratimit nga AMLF-ja përpara shitjes, lënies peng, dhurimit, si dhe çdo formë tjetër të disponimit të makinave/mjeteve që janë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 7 të këtij udhëzimi duhet të vërtetojnë se subjektet përfituese të këtyre makinave/mjeteve të jenë të licencuar

për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit.

Ndalohet dhënia me qira e makinave/mjeteve që shërbejnë për ushtrim veprimtarie lojërash fati, subjekteve të papajisura me licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

10. Dokumentacioni i përcaktuar në këtë udhëzim duhet të jetë i lëshuar/miratuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga organet përgjegjëse, si dhe duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuara.

11. Në rastet e shitjes, lënies peng, dhurimit dhe çdo forme tjetër të disponimit të aksioneve, aseteve, pasurisë apo makinave të organizatorit të shoqërisë të licencuar për Lotarinë Kombëtare, zbatohen dispozitat e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare.

KREU III PROCEDURA E DHËNIES SË MIRATIMIT

12. Kërkesat për dhënie e miratimit paraprak në rastin e shitjes, lënies peng, dhurimit dhe çdo forme tjetër të disponimit të aksioneve, aseteve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit paraqiten pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

13. AMLF merr në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga organizatorët e lojërave të fatit brenda një afati prej 45 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për dhënie e miratimit.

14. Në rast se AMLF konstaton mungesa apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur njofton me shkrim aplikuesin duke i caktuar edhe afatin përkatës për plotësimin e dokumentacionit në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

15. Në rast se AMLF pas shqyrtimit konstaton se dokumentacioni është në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi, ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” dhe legjislacionit në fuqi, lëshon miratimin paraprak për shitjen, lënien peng, dhurimin dhe çdo forme tjetër të disponimit të aksioneve, aseteve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit duke njoftuar me shkrim aplikuesin.

16. AMLF-ja, përveç dokumentacionit të paraqitur nga subjektet aplikuese për marrjen e miratimit, ka të drejtën e kryerjes së verifikimeve për vërtetësinë e këtyre dokumenteve. Në rastin e kryerjes së verifikimeve afati i përcaktuar në pikën 12 të këtij udhëzimi pezullohet deri në marrjen e konfirmimeve nga organet përgjegjëse.

17. AMLF-ja refuzon kërkesën për miratimin e shitjes, lënies peng, dhurimit dhe çdo forme tjetër të disponimit të aksioneve, aseteve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit në rastin kur aplikuesi:

- a) nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë udhëzim; ose
- b) nuk plotëson brenda afatit e caktuar nga AMLF mangësitë e konstatuara në dokumentacion.

Për vendimin e refuzimit të dhënies së miratimit paraprak AMFL njofton me shkrim aplikuesin.

18. Kundër vendimit të AMLF-së për refuzimin e dhënies së miratimit, organizatori i lojërave të fatit ka të drejtën e ankimit në gjykatën administrative kompetente në përputhje me ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

19. Udhëzimi nr. 3, datë 19.1.2009, “Për rastet e shitjes, transferimit të aksioneve të shoqërive të licencuara të lojërave të fatit”, shfuqizohet.

20. Për kërkesat e dhënies së miratimit të paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, të cilat janë në proces shqyrtimi nga AMLF-ja do të zbatohen parashikimet e udhëzimit nr. 3, datë 19.1.2009, “Për rastet e shitjes, transferimit të aksioneve të shoqërive të licencuara të lojërave të fatit”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj